



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALBANA XH. SPAHIU  
ADRESA NR.9, HAXHI HYSEN  
DALLIU, NR.59, NR.11  
TEL: 672530602

# PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 4794

Nr. koleksioni: 1533

Tirane më 26/12/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023051000163877400



A2023051000163877400



## AKT THEMELIMI & STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

#### “REPORTAGE ALBANIA” shpk

Sot, më datë 26 Dhjetor 2023, para meje Notere ALBANA XH. SPAHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, HAXHI HYSEN DALLIU, NR.59, NR.11, u paraqiten personalisht:

**Z. Giovanni Emanuele Nucera**, atesia Andrea, shtetas italian, lindur në Pietra Ligure (SV), Itali, më 10/06/1997, banues në Vila 25, stret 7, Hidd Al Saadiyat, Saadiyat Island, Abu Dhabi; Emiratet E Bashkuara Arabe, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me pasaporte italiane nr. Y81071091, i perfaqësuar me prokurë të Posacme e leshuar me date 21/12/2023, në Abu Dhabi; Emiratet E Bashkuara Arabe, e perkthyer dhe e noterizuar, nga Z. Klodian Kamenica, me Gjeneralitete si më poshtë.

**Z. Klodian Kamenica**, atesia Pandi, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më 18/06/1976, banues në adresë ALEKSANDER GOGA Nd. 46; H. 1; DURRËS; 2003; DURRËS, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me Pashaportë Biometrike nr. BD7518711, dhe Nr. Personal H60618060C.

Të cilët me cilësinë e “Ortakëve Themelues”, më kërkuan hartimin e këtij Akti Themelimi & Statut për një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, nëpërmjet të cilit deklarojnë se, me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligj ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, Ligj 10428 datë 2.6.2011 “për të drejtën ndërkombëtare private”, Ligj 79/2021 “per te huajt”, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, krijojnë nëpërmjet këtij Akti, shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “REPORTAGE ALBANIA” shpk, Tiranë.

## KAPITULLI 1

### Neni 1 - Themelimi

Shoqëria “REPORTAGE ALBANIA” shpk, Tiranë, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

### Neni 2 - Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “REPORTAGE ALBANIA” shpk, Tiranë, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në



A202305100016387400

kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbjet e shoqërisë dhe detyrime ndaj të tretëve, vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të saj, në kapitalin themeltar.

### Neni 3 - Selia dhe Territori

Shoqëria e do të ketë selinë në adresë: Rruga Haxhi Hysen Dalli, Ndertesa Nr 59, Nr 9, Tirane (Albania).

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Mbledhjes së Asamblese së Ortakeve.

### Neni 4 - Objekti i veprimtarisë

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë:** Investime në Shoqëri pasurish të paluajtshme. Zhvillim Institucional, menaxhim, ndertime civile, investime. Mundet gjithashtu të kryejë të gjitha operacionet tregtare, financiare, mobiliare e imobiliare që eventualisht konsiderohen të nevojshme dhe oportune për të arritur ose nxitur permbushjen e objektivit social. Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndertimit. Pjesëmarrja përmes blerjes së aksioneve ose formave të tjera direkte ose indirekte në shoqëri të tjera. Ndertim i objekteve të banimit, civile dhe industriale duke përfshirë të gjitha fushat në sektorin e ndertimit.

### Neni 5 - Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar (pa afat), duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

## KAPITULLI 2

### KAPITALI

#### Neni 6 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë "REPORTAGE ALBANIA" shpk është 10,000 EURO (dhjetë mijë Euro) = 1,038,700 Lekë (Kursi Zyrtar i Bankes së Shqipërisë, date 26/12/2023 është 1 Euro = 103.87 Lek), i investuar nga ortakët në proporcion me kuotat e tyre të aksioneve;

Ortakët kanë kontribuar në themelimin e shoqërisë dhe posedojnë kuotat në proporcion si më poshtë:

1. **Ortaku Giovanni Emanuele Nucera**, posedon **1 (një) kuotë** të kapitalit themeltar të shoqërisë "REPORTAGE ALBANIA" shpk, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej **90 %** të kapitalit të shoqërisë 9,000 Euro = 984,830 Lek.

2. **Ortaku Klodian Kamenica**, posedon **1 (një) kuotë** të kapitalit themeltar të shoqërisë "REPORTAGE ALBANIA", shpk e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej **10 %** të kapitalit themelues të shoqërisë 1,000 Euro = 103,870 Lek.

Ortakët nuk përgjigjen personalisht, (si persona fizik) për detyrimet e shoqërisë "REPORTAGE ALBANIA" shpk. Ata përgjigjen për humbjet e shoqërisë aq sa është pjesa e tyre e kuotës së investuar.

Ortaku i cili pengohet në ushtrimin e të drejtës që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë ka të drejtë të kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimit të demit të shkaktuar, e drejtë e cila parashkruhet pas tre vjetëve.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortakët i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortakët i mbetur nuk përmbushin këtë detyrim, atëherë ortakët përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht".

#### Neni 7 - Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit



A202303100016387400

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakëve të cilët duhen të kryejnë pagesat në raport me përqindjet e kapitalit që ato zotërojnë, ky vendim asamblese së përgjithshme të ortakëve duhet të jetë me shumicën e 3/4 (tre të katërtave) të votave të ortakëve pjesmarrës.

Nëse ndonjeri nga Ortaket nuk do që kuoten e tij të kapitalit të zmadhohet, kjo e drejtë do t'i përkase ortakëve të tjerë. Në këtë rast do të riformatohet raporti përfasues i ortakëve të shoqërisë, në bazë të kontributit të tyre në kapitalin themelues të zmadhuar.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme, në të njëjtat kushte që kërkohen për zmadhimin e kapitalit si dhe për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet, ulja e kapitalit është në përpjesëtim me pjesët takuese të kapitalit që përfaqësojnë Ortakët, dhe nuk mund të jetë me i vogël se minimumi i paashikuar nga ligji në fuqi. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit, i komunikohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, nga administratori, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Kuotat e kapitalit të shoqërise nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale.

Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

### **Neni 8 - Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b) shitjes,
- c) trashëgimisë,
- d) dhurimit,
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

-Në rastin e kalimit të aksioneve me kontratë, kjo kontratë duhet të bëhet me shkrim.

-Statuti mund ta kushtëzojë transferimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin ose të drejtën e parablerjes së shoqërisë në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë. Transferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjesëve të tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyre:

-Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim ose mjete elektronike;

-Oferta duhet të percaktoje numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;

Nese Ortaku i shoqërise brenda 30 dite nga oferta me shkrim (te saktësuar me fletemarrjen postare) nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e percaktuar, atehere konsiderohet se ata lejojnë shitblerjen tek te tretet.

Nese me shume se një nga Ortaket shpreh dëshirën për të ushtruar të drejtën e parablerjes së kuotes së kapitalit në shitje, kuota do të ndahet në mënyre të përpjesëtime me kuotat ekzistuese.

-Në rastin e transferimit të kuotave me kontratë, afatet dhe kushtet e transferimit të titullit të kuotës, si dhe kushtet e tjera kalimtare, duke përfshirë pagesën për blerjen e kuotave, rregullohen nga kontrata.

## **KAPITULLI III**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE MENAXHUESE**

#### **Neni 9 - Organi i Vendimmarrjes**

-Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton ndryshimet në



A2023051000163877400

statut sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet e marra nga shoqëria për sa vijon:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet statutores;
- c. emërimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- ç. emërimi dhe heqja e likuidatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimi dhe shpërblimi i personave të cituar në gërmat “c” e “ç” të kësaj pike;
- dh. mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorit, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. miratim të bilanceve vjetore dhe raporteve mbi progresin e biznesit;
- f. zmadhim dhe zvogëlim të kapitalit;
- g. ndarja e kuotave si dhe anulimi i tyre;
- h. përfaqësimi i shoqërisë në gjykim dhe procedime të tjera kundrejt Administratorit;
- i. riorganizim dhe shpërbërje të shoqërisë;
- j. miratimi i rregullave procedurale për mbledhjet e Asamblesë;
- k. të drejtën për të kërkuar si dhe për të marrë kredi ose hua, pranë çdo banke te nivelit të dytë, institucioni financiar, shoqëri tregtare ose person fizik shqiptar/e ose të huaj/a.
- l. Çështje të tjera të parashikuara në ligj ose në Statut.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme, nga një ortak tjetër ose nga një palë e tretë me anë të një autorizimi ose prokure.

Autorizimi mund të jepet vetëm për pjesëmarrje në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet e ardhshme që do të kenë të njëjtin rend dite.

Shoqëria do të drejtohet nga 1 (një) Administrator. Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë. Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare është **Z. Klodian Kamenica**, duke filluar nga data 26/12/2023. Administratori mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër shqiptar ose i huaj me anë të një, autorizimi, Prokure të Posaçme ose Prokure të Përgjithshme.

Administratori është përfaqësuesi i shoqërisë dhe përfaqëson atë në të gjitha marrëdhëniet e saj me të tretë.

Administratori ka të gjitha të drejtat dhe tagrat e përfaqësimit të shoqërisë pa kufizim (*edhe ato që nuk janë specifikuar në këtë statut*), por jo ato që specifikisht janë përcaktuar si kompetence dhe të drejta vetem e Asamblesë e Përgjithshme, (sipas parashikimit të nenit 81 të ligjit).

#### **Neni 10 - Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Mbledhja e përgjithshme thirret me komunikim me shkrim ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim me e-mail. Njoftimi me letër ose e-mail duhet të tregojë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me pikën 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët pranojnë të marrin vendime, pavarësisht nga rregulli i mësipërm.

#### **Neni 11 - Kuorumi**

Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të diskutojë në mënyrë të vlefshme vetëm nëse Ortakët me të drejtë vote zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rast se mbledhja vendos për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë personalisht të pranishëm Ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave, duke votuar me anë të një letre ose me mjete elektronike, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 3 të nenit 88 të këtij ligji.



A2023051000163877400

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë nen, mbledhja do të thirret sërish jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 12 - Procesi i vendimmarrjes**

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të Ortakëve pjesëmarrës ndryshimin e statutit, rritjen ose pakësimin e kapitalit themeltar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë votash të Ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si p.sh:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet statutores;
- c. emërimi dhe shkarkimin e Administratorit;
- ç. Emërimi dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimit për administratorin, ekspertet dhe likuidatorit.
- dh. Mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. përfaqësimi i shoqërisë në procese gjyqësore dhe procedime të tjera kundrejt Administratorit;
- f. aprovimi i procedurave rregullatore të mbledhjeve të Asamblesë

Çdo ndryshim ligjor duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për t'u pasqyruar në dosjen e shoqërisë.

### **Neni 13**

#### **Përfundim nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme vendos:

- a. shqyrtimin e veprimtarisë së tij
- b. shkarkimin nga çdo detyrim nën kujdestarinë e tij
- c. paraqesë një denoncim kundër tij nga Shoqëria
- ç. Nëse do t'i jepen ose jo përfitime të reja.

Kur Ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, për këtë të fundit duhet të përjashtohet paraprakisht konflikti i interesave me ato të ortakut që ai përfaqëson.

### **Neni 14 - Administrimi**

**Z. Klodian Kamenica** është Administrator sipas Statutit dhe Ligjit për një periudhë kohore prej 5 (pesë) vjet me të drejtë rinovimi duke filluar nga data 26 Dhjetor 2023 – 25 Dhjetor 2028.

Asambleja e përgjithshme mund t.i shkarkojë administratorët në çdo kohë kur arrihet shumica. Statuti ose marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë.

Gjithashtu, Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të njërit prej ortakëve.

Të drejtat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre duhet të njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person, jo ortak.

Administratori ka të drejtë të hapë dhe të mbyllë llogari bankare vet ose nepermjet nje personi tjetër me autorizim.

### **Neni 15 - Kompetencat**

Administratori autorizohet dhe ka detyrimin të:

- a) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të aktivitetit tregtar, duke aplikuar politikat tregtare të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare vet ose nepermjet personave të tretë me autorizim.
- c) ofrojë asistencë për mirëmbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.



A2023051000163877400

- ç) hartojë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe ia dorëzon këto dokumente Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë.
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme për shoqërinë, sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportojë së pari para Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë për biznesin e shoqërisë tregtare.
- f) të lidhi kontrata të ndryshme me subjete të tjera që mund të jenë persona fizik ose juridik.
- g) kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe Statuti.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e zakonshme të menaxhimit. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridikë, autoriteteve publike dhe/ose private, vendase ose të huaja, përfshirë autoritetet gjyqësore të të gjitha niveleve, bankat e të gjitha niveleve, etj. Administratori ka kompetencë të veprjë në marrëdhënie me të tretët për llogari të shoqërisë, si dhe para bankave të të gjitha niveleve, të kryejë transfertat, tërheqje etj., pranë zyrave të tatimeve, zyrave të administratës vendore, punës, doganave, autoritetet etj. Në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji u jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori e përfshin shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve në përputhje me objektin e tij të veprimtarisë.

### Neni 16 - Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori përgjigjet personalisht për shoqërinë ose për të tretët, për shkelje të ligjit, për shkelje të statutit ose për shkelje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që dëmtojnë shoqërinë, i ngarkohen Administratorit ose ortakëve që kanë lidhur marrëveshjen për t'u marrë individualisht ose bashkërisht me pasojat e rastit në fjalë.

Me përjashtim të asaj që parashikohet nga dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, në zbatim të neneve 14, 15, 17, 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori është i detyruar të:

- 1). A) kryejë funksionet e tij, të përcaktuara në legjislacion dhe statut, në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në përgjithësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë në kontekstin social.
  - b) ushtrojë kompetencat e njohura në ligj dhe statut vetëm për të arritur objektivat e përcaktuara në këto dispozita.
  - c) shqyrtojnë me përgjegjësi maksimale çështjet për të cilat marrin vendime.
  - Ç) parandalojë dhe shmangë rastet e konfliktit aktual ose të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë.
  - d) të ushtrojë funksionet e tij me profesionalizëm dhe përgjegjësi maksimale.
- 2) Administratori gjatë ushtrimit të detyrës i përgjigjet shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të pyetjeve dhe vlerësimit të informacionit përkatës, akti i veprimit ose mosveprimit është kryer në mirëbesim.
- 3) Në rast se Administratori vepron në kundërshtim me detyrat e tij dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ai është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nga shkelja dhe i kërkohet të kthejë fitimet që, ai dhe personat e lidhur, kanë gjeneruar, nga këto veprime të parregullta.
- 4) Në veçanti, por jo ekskluzivisht, Administratori është i detyruar t'i shlyejë shoqërisë çdo dëm të shkaktuar, në rast se bie ndesh me ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duke kryer veprimet e mëposhtme:
- A) shlyerjen e kontributeve për Ortakët;



A2023051000165877400

- B) pagesë të interesave ose të dividendit Ortakëve;  
C) ndarjen e aktivitetit të shoqërisë,

Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndërpresë ngritjen e padisë ndaj Administratorit për lëshimet e kryera prej tij në ushtrimin e detyrës.

#### **Neni 17 - Konfidentaliteti**

Ortakët e shoqërisë si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj

#### **Neni 18 - Dokumentet e destinuar për të tretët**

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuar për të tretët, si letrat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshem emrin e shoqërisë dhe pas tij inicialet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "shpk", si dhe emrin e administratorit.

#### **Neni 19 - Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 20 - Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur edhe humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### **Neni 21 - Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga nga Asambleja e Përgjithshme.

Për qëllime të kontrollit nga ana e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, përgatitet raporti me shkrim për nxjerrjen e rezultateve të bilanceve vjetore edhe për atë të kontroleve periodike të ushtruara, i cili duhet t'i paraqitet në kohë Asamblesë së Përgjithshme për t'u shqyrtuar dhe miratuar.

#### **Neni 22 - Bilanci Kontabël**

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetëm, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj.

#### **Neni 23 - Shpërndarja e të ardhurave**

Të ardhurat i shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesëmarrjen dhe kuotat e tyre.

Shoqëria mund të shpërndajë të ardhurat vetëm nëse:

-Aktivet e shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e tyre.

-Shoqëria posedon aktive në likuiditet të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm





A2023051000163877400

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi, si dividend, ortakeve të shoqërisë:

#### Neni 24

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë dhe për çfaredo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar sic mund të jete:

- a- Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- b- Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare"
- c- Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri ne likuidim e sipër".

#### Neni 25

Likuidatori merr përsipër të drejtat dhe detyrat e Administratorit që nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria cakton më shumë se një likuidator, përveç rasteve në të cilat akti i emërimit parashikon se ata veprojnë të pavarur nga njëri-tjetri, likuidatorët kryejnë bashkërisht të drejtat dhe detyrat sipas ligjit. Likuidatorët mund të autorizojnë njërin prej tyre për të kryer veprime të një kategorie të veçantë.

Likuidatori i nënshtrohet mbikëqyrjes së Ortakut dhe Administratorit/orëve.

#### Neni 26 - Të drejtat dhe Detyrimet e Likuidatorëve

1. Detyra e likuidatorëve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, njohja e kredive/huave dhe kontributeve të papaguara, shitja e aktiveve të shoqërisë dhe pagesa e kreditorëve duke respektuar urdhrin e referencës, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuidatori mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, me qëllim mbylljen e një veprimi jo të plotë.
3. Nëse, në bazë të ankesave të kreditorëve, sipas nenit 194 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", likuidatorët vërejnë se pasuritë e shoqërisë tregtare, përfshirë edhe kontributet e papaguara, nuk janë të mjaftueshme për pagesën e këtyre kërkesave, likuidatorët janë të detyruar të pezullojnë procedurën e likuidimit dhe të kërkojnë nga gjykata fillimin e procedurës së falimentimit.
4. Likuidatori përgatit një bilanc në lidhje me gjendjen e shoqërisë në momentin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në momentin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuidatori përgatit raportin financiar vjetor të shoqërisë. Buxhetet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### Neni 27 - Finalizimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuidatori njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon mbylljen e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 05.03.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" e ndryshuar.

#### Neni 28

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne QKR.

#### Neni 29

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.



A2023051000163877400

### **Neni 30 - Shkrirja**

Dy ose më shumë kompani mund të bashkohen përmes:

1. Transferimi i të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të një ose më shumë shoqërive, të quajtura shoqëri të inkuorporuara, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëri blerëse, në këmbim të aksioneve ose kuotave të asaj shoqërie.
2. Krijimi i një shoqërie të re, së cilës i kalojnë të gjitha aktivet dhe detyrimet e shoqërive ekzistuese, të cilat bashkohen në këmbim të aksioneve ose kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet shkrirje me krijimin e një shoqërie të re.

### **Neni 31 - Bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku e shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme. Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj tek shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

### **Neni 32 - Konvertimi**

Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Konvertimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë në përgjegjësi ndaj palëve të treta.

### **Neni 33 - Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Ligji për QKB, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 34**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e e Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

### **Neni 31**

#### **Dispozita përfundimtare**

Ky Statut është hartuar në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore, në shqip dhe italisht dhe është miratuar në tërësi nga aksionerët e shoqërisë tregtare "REPORTAGE ALBANIA" *Shpk*, dhe nënshkruhet rregullisht prej tyre

Të gjitha kopjet e statutit nënshkruhen duke shkruar emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr.



A2023051000163870400

110/2018 “Për Noterinë”, vërtetohet nënshkrimin e tyre.

Ortakët themelues deklarohen se kanë dhënë pëlqimin, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pra për trajtimin e tyre nga unë noterja, si dhe për gjenerimin e dokumentacionit të nevojshëm nga portali shtetëror e-albania.

Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklarohet se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Taksa e pulles 200Lek në aktin e Arkivit

**ORTAKËT**

**Giovanni Emanuele Nucera**

(perfaqësuar me Prokuror të Posacme nga Klodian Kamenica)

**NOTERE  
ALBANA XH. SPAHIU**

**Klodian Kamenica**